



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

13-01-2022
02/06

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 11.01.2022

PROCESVERBAL

i mbledhjes së parë (I) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I D I T Ë S

1. Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Mbledhja u mbajt me datë: 17.12.2021 dhe filloi në ora: 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 30 asambleistë, kryetari z.Ekrem Kastrati, përfaqësues nga OSBE-ja, ish-kryesuesi Rrahim Morina, kryetari i KQZ-së në Malishevë z. Rexhep Zogaj, qytetarë nga komuna e Malishevës, media dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi antari më i vjetër i Kuvendit z.Hajdin Berisha.

Hajdin Berisha: Të nderuar asambleistë! I nderuar ish-kryesues i Kuvendit Rrahim Morina, i nderuar kryetar i KQZ-së z.Rexhep, të nderuara media, përfaqësues të OSBE-së, përshëndetje për të gjithë ju dhe mirësekeniardhur në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të asmblesë komunale!

Dje kemi marrur një lajm të dhimshëm. Kemi humbur një puntorë të vyer arsimor, një drejtor

dhe menaxher i shkollës fillore të mesme të ulët "Ismail Qemali" në Bellanicë. Në shenjë nderimi dhe respekti për ish drejtorin, tashmë i ndjerë z.Sertolli, ju ftoj për një minutë heshtje! Lavdi!

Ftesën dhe rendin e ditës e keni marrur me kohë. Prezent në sallë janë 30 asambleistë.

Pikat e rendit të ditës janë:

1. Formimi i komisionit për mbarevajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Kush është për rendin e ditës?

Për: 14

Kundër: 15

Abstenim: 1

Me 14 vota për, 15 kundër, 1 abstenim, rendi i ditës nuk kalon. Për shkak të mosmiratimit të rendit të ditës, mbledhja vazhdohet në seancën e radhës. Faleminderit!

Mbledhja përfundoi në ora: 10:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Antari më i vjetër i Kuvendit

